

Rahovecin/Orahovac, policia serbe e ka arrestuar Tekiun dhe vëllezërit e tij dhe i ka çuar në Stacionin e Autobusëve. Aty, Tekiun e ndan nga vëllezërit dhe me grupin prej afro 20 burrash i transferuan në stacionin policor në **Prizren**. I vëllai Xhemajli, më 27.07.1998, pyeti për fatin e të vëllait në stacionin policor. I thanë se Tekiu ishte aty, por që “ende kishin punë me të”. Tekiun e liruan një ditë më vonë. Ishte në gjendje të rëndë - i fryrë nga rrahjet dhe me shputat e mavijosura të këmbëve nga dajak. Në datën 2.08.1998, e pranuan në spitalin e Prizrenit/Prizren, nga ku, ditën tjetër, e transferuan në spitalin e Prishtinës/Priština. Ndërroi jetë pas dy ditësh [4.08.1998]. Po atë ditë, Xhemajli e ka çuar trupin e të vëllait në shtëpi. Tekiun e kanë varrosur një ditë më vonë në varrezat e qytetit.

Burimet: deklarata Xh.R, FDH-35616; *Albanian Dies of Torture in Serb Police Custody*, pasqyra e lajmeve, KIC, 06.08.1998, FDH-29402.

Muhamet (Hamzë) Elshani

(15.11.1938, shqiptar nga Pirana/Pirane, komuna e Prizrenit/Prizren, mullis, tre fëmijë)

Afrim (Muhamet) Elshani

(19.01.1971, shqiptar nga Pirana/Pirane, komuna e Prizrenit/Prizren, mullis, dy fëmijë)

Salih (Azem) Gashi

(14.02.1982, ashkali nga Pirana/Pirane, komuna e Prizrenit/Prizren, punëtor, i pamartuar)

Muhameti, së bashku me bashkëshorten Sanijen, djemtë Afrimin dhe Lulzim, si dhe familjet e tyre, jetonte në Piranë/Pirane. E mbante një mulli elektrik për bluarjen e grurit. Salihu punonte te Muhameti në mulli. Në datën **5.08.1998**, Muhameti, Afrimi dhe Salihu, që nga mëngjesi, po punonin në fushë [**Piranë/Pirane**]. Rreth orës 20:00, një nga bashkëfshatarët që u ndihmonte në fushë, u kthye në shtëpi, ndërkaq Muhameti, Afrimi dhe Salihu vazhduan së punuari. Pas një ore, banorët e fshatit i dëgjuan disa të shtëna nga drejtimi i fushës, por nga droja askush nuk shkoi atje. Në mëngjes, shkuan në fushë dhe atje i gjetën trupat e pajetë të Muhametit, Afrimit dhe Salihut. Ishin të

ekzekutuar me plumba në kokë. Muhameti i kishte duar të lidhura me tel pas shpine, ndërkaq Afrimi i kishte nëpër trup shenjat e dukshme të torturimit. Një ditë para kësaj ngjarjeje, një furgon i tipit *Folkswagen*, të ngjyrës së argjendtë - metalike, ishte i parkuar afro 600 - 700 metra larg fshatit. I kishte targat civile. Familjarët i kanë varrosur trupa e Muhametit, Afrimit dhe Salihut në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata B.G, FDH-35612; deklarata D.E, FDH-36456; *Dnevnik od 1. do 7. jula*, Ilustrovana politika, 11.07.1998, FDH-32213; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.P.107A, FDH-922; *Bodies of Three Killed Albanians Found at Piranë, Prizren*, pasqyra e lajmeve, KIC, 06.07.1998, FDH-34047.

Idriz (Ramadan) Krasniqi

(4.06.1985, shqiptar nga Billusha/Biluša, komuna e Prizrenit/Prizren, nxënës)

Fshati Billushë/Biluša ka qenë shpesh në shënjestër të forcave serbe, për shkak të pranisë së forcave të UÇK-së në fshat. Policia serbe ka qenë e pozicionuar te vendi i quajtur *Laku i Keq/Zla okuka*, në rrugën magjistrale Prizren - Dragash/Dragaš. Për shkak të të shtënave dhe granatimeve, banorët e fshatit e kanë braktisur fshatin disa herë me radhë, duke u strehuar në pyllin e afërt. Ditën e enjte, më **6.08.1998**, Idrizi punonte me prindërit e vet në fushë. Atë ditë, ata u kthyen më herët në shtëpi, ndërkaq Idrizi ndenji për të kryer edhe diçka tjetër. Rreth orës 19:00, prindërit e tij i dëgjuan disa të shtëna që vinin nga drejtimi i fushës ku e kanë lënë të birin të punonte. I ati doli jashtë për të parë çfarë kishte ndodhur dhe, jo larg shtëpisë [**Billushë/Biluša**], e gjeti trupin e pajetë të të birit. E kishin qëlluar me pushkë snajperi në kokë. Fqinji i tyre, Veli Gashi, 55 vjeç, i cili tentoi t'i ndihmonte Idrizit, po ashtu, u qëllua dhe u plagos nga snajperi. Prindërit e kanë varrosur Idrizin, një ditë më vonë në pyllin e afërt. Pas lufte, në muajin gusht të vitit 1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Idrizit në varrezat e Billushës/Biluša.

Burimet: deklarata Z.K, FDH-8900; *Albanian Boy Killed, Man Wounded, by Serb Snipers in*